

UDHËZIM
Nr. 2, datë 8.5.2020

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 7.2.2011, PËR RREGULLAT E PËRBASHKËTA NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 14 “Dispozita e fleksibilitetit”, pas pikës 1, shtohen pikat 2 dhe 3 me përmbajtje si më poshtë:

“2. Në rastin e rrethanave urgjente të paparashikueshme, të cilat ndikojnë tek personat juridik apo fizik që i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të këtij udhëzimi, ose ndikojnë në nevojat urgjente operacionale të tyre, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të lejojë përjashtime nga zbatimi i dispozitave të këtij udhëzimi, kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) është e pamundur të adresohen në mënyrë të përshtatshme rrethanat apo nevojat përkatëse në përputhje me këtë udhëzim;

b) të garantohet siguria në operim, mbrojtja mjedisore dhe përputhja me kërkesat thelbësore të zbatueshme, aty ku është e nevojshme përmes aplikimit të masave zbutëse;

c) janë marrë masat që të zbutet sa më shumë të jetë e mundur çdo çrregullim i mundshëm i kushteve të tregut si pasojë e dhënies së përjashtimit; dhe

d) përjashtimi është kufizuar në qëllim dhe kohëzgjatje, në masën që nevojitet dhe është aplikuar në një mënyrë jodiskriminuese.

Në rastin e dhënies së përjashtimit, Autoriteti i Aviacionit Civil njofton menjëherë ministrin dhe merr masa për të njoftuar Komisionin Evropian, Agjencinë Evropiane të Sigurisë Ajrore (EASA) për përjashtimin e dhënë, kohëzgjatjen e tij, arsyen e dhënies së këtij përjashtimi dhe, sipas rastit, masat e nevojshme zbutëse të zbatuara.

3. Kur përjashtimi sipas referencës në pikën 2 më sipër, është dhënë për një kohëzgjatje që tejkalon tetë muaj të njëpasnjëshëm ose kur Autoriteti i Aviacionit Civil ka dhënë të njëjtin përjashtim në mënyrë të përsëritur dhe kohëzgjatja totale tejkalon tetë muaj, Autoriteti i Aviacionit Civil, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për transportin, do të vlerësojnë përmbushjen e kushteve të vendosura në pikën 2.

Në vijim të këtij vlerësimi, Autoriteti i Aviacionit Civil do të dalë me një vendim lidhur me rezultatin e këtij vlerësimi për të cilin do të njoftojë paraprakisht ministrin. Ky vendim do të merret brenda 3 muajve nga data e njoftimit të fundit, që i është përcjellë ministrit.

Kur vendimi konfirmon se kushtet e përcaktuara në paragrafin e parë të pikës 2, nuk përmbushen, Autoriteti i Aviacionit Civil, do të revokojë menjëherë përjashtimin e dhënë sipas pikës 2 të këtij neni.”.

Neni 2

Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku